



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:284740
Datë: 14.11.2024
Numri i dokumentit: 06453964

Në ankesën e

AC-I-24-0666

Paditësi/Ankuesi

Sh J fshati Ll e P, Podujevë, të cilin e përfaqëson B I, avokat, Prishtinë

Kundër

E paditura

NSH,FAN "Zahir Pajaziti", Podujevë, të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, AC-I-23-0100 të datës 16 maj 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 nëntor 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1 Ankesa e paditësit e paraqitur kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, AC-I-23-0100 të datës 16 maj 2024, hedhet poshtë si e pa lejueshme, për shkak se çështja është çështje e gjykuar-res judikata.

2 Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 15 maj 2014, paditësi ka dorëzuar në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN046-0457 të datës 14 prill 2014, me të cilin AL, e kishte refuzuar kërkesën e tij për kompensimin e pagave të papaguara, në shume prej 1,777.04 euro, për periudhën dhjetor 2002- mars 2005, nga NSH FAN "Zahir Pajaziti" Podujevë, (në likuidim). Kërkesa nga AL ishte refuzuara si e pavlefshme me arsyetimin se është parashkruar në baze të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Paditësi nga DHPGJS-ja ka kërkuar që ankesa e tij të aprovohet si e bazuar, të shfuqizohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit, dhe të detyrohet e paditura t'ia paguaj shumën e borxhit të cekur si me lartë. Paditësi në ankesë ka theksuar se e paditura nuk ua ka mohuar të drejtën në paga të pa paguara por kërkesën e ka refuzuar me pretendimin se është parashkruar, ndërsa sipas nenit 387 pa.1 të LMD-së parashkrimi ndërpritet kur debitori pohon borxhin. Përveç borxhit në ankesë është kërkuar pagesa nga NSH-ja edhe për interesin ligjor. Me ankesë dhe me parashtresën e dt. 01 janar 2023 ka dorëzuar në kopje: vendimin e Autoritetit të Likuidimit, listën e pagave të mbetura borxh të datës 24 mars 2006, pranim njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, librezën e punës dhe një njoftim mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës 24 mars 2006.

Me 12 dhjetor 2022, AKP-ja ka dorëzuar në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. AKP-ja në mbrojtje në ankesë ka propozuar që ankesa e paditësit të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i AKP-së, duke theksuar se kërkesa është e parashkruar, bazuar në nenin 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar. E paditura ka pohuar se ankesa është e pa pranueshme pasi që në kuptim të nenit 74.2 të Ligjit 06/L-086 parashihet që ankesa është e pa pranueshme pasi që në kuptim të nenit 74.2 të Ligjit 06/L086 parashihet që ankesa e dorëzuar në DHPGJS kundër vendimit të autoritetit të Likuidimit duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryes në përputhje me Ligjin 04/L-034 vetëm një ankesë e dorëzuar në

përputhje me kërkesat e nenit 27 të Shtojcës së Ligjit 04/L034 vetëm një ankesë e dorëzuar në përputhje me kërkesat e nenit 27 të shtojcës së Ligjit 04/L033, në këtë kuptim parashtuesi nuk ka vërtetuar se cili nen i këtij ligji është shkelur. Sipas të paditurës kërkesa e paditësit është e parashkruar dhe se perioda e parashkrimit nuk e lejon AKP-ë ose Dhomën e Posaçme të analizojë dhe shqyrtoje themelin e çështjes.

Me 23 janar 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, ka marrë Aktgjykimin C-IV-14-4032, me të cilin ka aprovuar pjesërisht ankesën si të bazuar dhe ka ndryshuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN046-0457, të datës 14 prill 2014, ashtu që ka obliguar të paditurën AKP, që ankuesit Sh Jnë emër të kompensimit për paga të pa paguara, t'i paguajë shumën prej 1,058.86, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës përtej shumes së aprovuar, është refuzuar si e pa bazuar, e cila shuma e aprovuara do të përmbushen në pajtim me prioritetin sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në Procedurën e likuidimit, si dhe obligohet e paditura AKP, që ankuesit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 124.00 euro. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se neni 42 pika 2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh e pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e desh misë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtresat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mendësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë. Edhe sipas nenit 7 të Ligjit për procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë. Po ashtu nenin 14.1 i rregullores së UNMIKU-ut 2001/27 (si ligj ne fuqi në kohen e ofrimit të shërbimeve të punës) parasheh që :” pagat-rrogat paguhen: (a) të paketën çdo muaj : (B) punonjësit personalisht ose përmes transferim bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës”. Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L212(si ligj në fuqi në kohen e nxjerrjes së vendimit) parasheh që:” I punësuari ka të drejtë në

pagë e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit. Shkalla e I-rë kishte konstatuar se nuk ishte kontestuese se paditësi ishte një punëtor i NSH Fan "Zahir Pajaziti", por ishte kontestuese çështja e parashkrimit të kërkesës për pagat e kërkuara. Shkalla e I-rë ka konstatuar se nga Libreza e punës vërtetohet fakti se paditësi ka krijuar marrëdhënie pune në NSH Fan "Zahir Pajaziti" nga data 08 maj 1972 deri më 05 shtator 2006, , nga lista e rrogave e datës 24 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH Fan "Zahir Pajaziti" punëtorit Sh J i kishte mbetur borxh pagat në shumë prej 1,058.86 euro për muajt, janar, shkurt mars dhe dhjetor 2004 si dhe janar, shkurt, mars 2005. Shkalla e I-rë kishte pranuar se si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe listën e rrogave për të arritur në përfundim se paditësi ka ofruar shërbime pune për NSH për periudhën e lartcekur dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar te kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se paditësi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e rrogave lëshuar nga personi përgjegjës i NSH. Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi përtej 1,058.86 euro, gjykata është e bazuar në listën e rrogave, për muajin janar 2004 i është njohur paga në shumë prej 156.22 euro, për muajin shkurt 2004 i është njohur paga në shumë prej 183.96 euro për muajin mars 2004 i është njohur paga në shumë prej 195.11 euro për muajin dhjetor 2004 i është njohur paga në shumë prej 172.19 euro po ashtu paditësi për muajin janar 2005 i është njohur paga në shumë prej 114.07 euro, për muajin shkurt 2005 i është njohur paga në shumë prej 114.95 euro dhe për muajin mars 2005 i është njohur shumë prej 122.36 euro , ku gjithsejtë paditësit i është njohur shuma prej 1,058.86 euro me përjashtim të pagave të pa paguara për muajt dhjetor 2002, janar, shkurt dhe mars 2003, te cilat janë refuzuar për shkak të parashkrimit.

Shkalla e I-rë kishte vlerësuar edhe pretendimet tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur ne lidhje me objektin e kontestit por të njëjtat nuk kane ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e paditësit e tera është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Shkalla e I-rë kishte vlerësuar se për periudhën 24 mars 2003 e tutje, parashkrimi është i ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësisoj pretendimi i të paditurës se kërkesa

është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Më 15 shkurt 2023, AKP-ja kishte parashtruar ankesë pranë Kolegjit të Apelit kundër Aktgjyimit C-IV.-14-4032, për shkak të gjitha arsyeve ankimore, me propozimin që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar duke e refuzuar padinë ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit si të pa bazuar dhe ta vërtetojë Vendimin e Autoritetit të Likuidimit. AKP-ja thekson se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka bërë vlerësim të gabuar të situatës faktike dhe rrjedhimisht edhe të asaj juridike. Autoriteti i likuidimit thekson se pretendimet e parashtruesit janë parashkruar pasi se nuk ka asnjë provë para AL-së që parashtruesi i ka dorëzuar këto kërkesa para ndonjë Gjykate apo organi tjetër kompetent para se te përfundonte periudha e parashkrimit. AKP-ja ka theksuar se Gjykata ka ngatërruar çështje të rëndësishme faktike e rrjedhimisht edhe juridike dhe për pasojë ka bërë vlerësim të gabuar dhe ka marrë aktgjykim të pa drejtë. Parashtruesi nuk ka arritur të sigurojë dokumentacionet dhe dëshmitë e nevojshme për aprovimin e kërkesës së paditësit. Tutje AKP-ja në ankesë pohon se paditësi nuk ka saktësuar cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur, duke pohuar se DHPGJS-ja ka kompetencë të shqyrtoi vetëm ligjshmërinë e vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Tutje AKP-ja pohon se gjykata duhet të lëshohet në shqyrtimin e çështjes dhe të marrë në konsideratë argumentet e ngritura të Autoritetit të Likuidimit.

Me 07 mars 2024, përfaqësuesi i paditësit përmes përgjigjes në ankesë ka kundërshtuar pretendimet ankimore të AKP-së si të pa bazuara meqë shkalla e parë ka administruara dhe nxjerr të gjitha provat e propozuar e të cilat kanë qenë të nevojshme për ti vërtetuar faktet vendimtare. Përfaqësuesi i paditësit i referohet edhe disa rasteve nga jurisprudenca e Kolegjit të Apelit. Ai ka kërkuar nga Kolegji i Apelit që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i animuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe te detyrohet e paditura që te bëjë kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, për hartimin përgjigjes në ankesën e AKP-së ndaj Aktgjyimit të shkallës së parë në shumën prej 208 euro, sipas nr. Tariforë 9. Paditësi në përgjigjen në ankesë ka

kërkuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e AKP-se dhe të vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së parë.

Me datë 16 maj 2024, Kolegji i Apelit e ka refuzuar ankesën e të paditurës si të pa bazuar dhe ka vërtetuar Aktgjykimin e ankiumuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Kolegji i Apelit ka arsyetuar Kolegji i Apelit vëren që Shkalla e I-rë kishte marrë Aktgjykimin me të cilin ka aprovuar pjesërisht ankesa si të bazuar, ka ndryshuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN046-0457, të datës 14 prill 2014, dhe ka obliguar të paditurën AKP, që paditësit, në emër të kompensimit për paga të pa paguara, t'i paguajë shumën prej 1,058.86, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës përtej shumes së aprovuar, e ka refuzuar si të pa bazuar. E paditura në procedurën ankimore edhe me tutje e mbetet pranë qëndrimit të saj të paraqitur gjatë mbrojtjes në Shkallë të I-rë, se kërkesa e paditësit për pagat të papaguara është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Ajo rithekson se paditësi ka dështuar të paraqet prova në gjykatë se ai i ka kërkuar pagat e papaguara brenda 3 viteve, nga koha kur NSH nuk i ka paguara pagat paditësit. Kolegji i Apelit vëren se paditësi në Shkallën e I-rë bashkë me ankesën e tij ka dorëzuar: autorizimin për përfaqësim nga avokati, vendimin e Autoritetit të Likuidimit, kopjen e librezës së punës, kopjen e njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës në NSH dt. 24 mars 2006 dhe kopjen e listës së pagave të mbetura borxh e përpiluar nga NSH-ja e të nënshkruara nga zyrtaret përgjegjës të NSH-së, dt. 24 mars 2006. Kolegji i Apelit ashtu siç ka konstatuar edhe Shkalla e I-rë konsideron që Njoftimi i ish AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës që është prezantuar si provë në gjykatë, e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës, për pagat e papaguara nga muaji mars 2003 e deri në mars 2005. Ky njoftim në përmbajtjen e tij përcakton se "shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura". Andaj duke u bazuar në këtë Njoftim të AKM-së, pas fillimit të procedurave të likuidimit, paditësi e ka paraqitur kërkesën e tij për paga tek Autoriteti i Likuidimit siç ishte njoftuar me njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies të punës me datë 24 mars 2006. Edhe Kolegji i Apelit vlerëson se paditësi i takon e drejta në kompensimin e

pagave të pa paguara duke u bazuar në listën e nënshkruar nga menaxhmenti i NSH-së, sipas së cilës paditësit i janë mbetur borxh paga e papaguara të aprovuara nga Kolegji i Shkalles së parë, për muajit janar-shkurt-mars 2004, për muajin dhjetor 2004 dhe pagat për përudhen janar- shkurt, mars 2005, dhe duhet ti paguhen paditësit në shumën e tërësishme prej 1,058.86 euro. Andaj duke u bazuar në këto arsye, pretendimet e të paditurës se kërkesa e paditësit për paga është parashkruar, janë të pathemelta ashtu që refuzohet ankesa e të paditurës si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Me datë 4 shtator 2024, paditësi përmes postës e dorëzon një parashtresë, të cilën ai e quan kërkesë. Kjo parashtresë në përmbajtjen e saj i referohet Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, AC-I-23-0100 të datës 16 maj 2024. Kjo parashtresë është dërguar nga vet paditësi e jo nga avokati i tij i cili deri më tani e ka përfaqësuar këtë paditës në procedurën lidhur me kërkesën e tij për paga. Në këtë parashtresë paditësi i referohet ankesës së tij të datës 15 maj 2014 të paraqitur në Shkallën e I-rë ndaj vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij për pagesën e pagave për periudhën dhjetor 2002 mars 2005 nga NSH FAN " Zahir Pajaziti ", Podujevë në shumën prej 1,777.04 euro. Tutje në këtë parashtresë paditësi konsideron se kërkesa e tij nuk është parashkruar pasi që është larguar nga puna me 24 mars 2006. Tutje ai pohon se gjykata nuk e vlerësuar gjendjen faktike dhe ka kërkuar që të aprovohen të gjitha pagat sipas kërkesës të parashtruar më herët.

Me datë 22 tetor 2024, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditëses. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditëses si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit hedhet poshtë si e pa lejueshme.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Pranueshmëria e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Kolegji i Apelit verën se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të datës 15 maj 2014 të paraqitur kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN046-0457 të datës 14 prill 2014, me Aktgjykimin C-IV-14-4032 të datës 23 janar 2023 e ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit si të bazuar, e ka ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, dhe e ka obliguar AKP-në që në emër të pagave të pa paguara nga muaji mars 2003, deri në mars 2005 ti paguaj paditësit shumën prej 1,058.86 euro, si dhe shpenzimet e procedurës prej 124 euro.

Ndaj Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-4032 të datës 23 janar 2023 ,ka paraqitur ankesë vetëm AKP-ja e jo edhe paditësi.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se ky Kolegj me Aktgjykimin e tij, AC-I-23-0100 të datës 16 maj 2024, e ka refuzuar ankesën e të paditurës si të pa bazuar dhe e ka vërtetuar Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Kolegji i Apelit vëren se parashtresa e paditësit e datës 4 shtator 2024 në fakt në bazë të përmbajtjes së saj ka pretendime ankimore dhe kjo parashtresë është regjistruar nga zyra e regjistrimit si ankesë e paraqitur ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit AC-I-23-0100 të datës 16 maj 2024.

Me këtë parashtresë paditësi i kërkon të gjitha pagat e kërkuara për periudhën dhjetor 2002 e deri mars 2005, duke konsideruar se këto paga nuk janë parashkruar. Në fakt DHPGJS-ja në të dy shkallët gjyqësorë ia ka njohur paditësit të drejtën në kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën mars 2003- mars

2005 në shumë prej 1,058.86 euro, duke konstatuar se pagat e kësaj periudhe nuk janë parashkruar, kurse pagat e periudhës dhjetor 2002 e deri shkurt 2003, janë parashkruar.

Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit, AC-I-23-0100 i datës 16 maj 2024 në bazë të nenit 9.14 të LDHP-së është Aktgjykim i formës së prerë, dhe ndaj tij nuk ka mundësi të paraqitet ankesë.

Për më tepër DHPGJS-ja ka vendosur në të dy shkallët gjyqësore lidhur me kërkesën e paditësit për paga, dhe çështja e tij në bazë të nenit 391 par.1.pika d) të LPK-së, konsiderohet si çështje e gjykuar-res judikata.

Prandaj nga arsyet e cekura parashtresa/ankesa e paditësit e datës 4 shtator 2014, është hedhë poshtë si e pa lejueshme.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në diapozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksat gjyqësore

Paditësi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore për procedurën ankimore bazuar në nenin 8.1 nënpika 8.1.2 lidhur me nenin 8.3 nënpika 8.3.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikim e taksave gjyqësore të KGJK-së.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 14 nëntor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues _____